LIGJ
Nr.10 322, datë 23.9.2010

PËR RATIFIKIMIN E SHTESËS SË KONTRATËS KONCESIONARE "PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE TË PASAPORTAVE ELEKTRONIKE" NDËRMJET MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE GRUPIMIT TË SAGEM SECURITE DHE FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet shtesa e kontratës koncesionare "Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike" ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit SAGEM SECURITE dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6706, datë 6.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi